



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:236773

Datë: 19.04.2021

Numri i dokumentit: 01700490

P.nr.51/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm, e përbërë nga gjyqtari Murrat Hulaj, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Ylberja Gollganit, në çështjen juridiko penale të akuzuarit H. B. nga, për vepër penale., **Rrezikim i trafikut publik**, parashikuar nga neni 378 par 8 lidhur me par. 6 e lidhur me par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP.nr.1809/19 të datës 16.10.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 15.04.2021, në prezencë të Prokurores të shtetit Sadije Muriqi, te akuzuarit H. B. , perf. Ligjor i te dëmtuarës B. S. bashke me te dëmtuarën-te miturën L. S., te njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërkaq me dt.16.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

H. B., i biri i Sh. dhe nenës M. e gjinisë L., i lindur me dt. ne, Republika e, ku edhe banon, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, me profesion drejtor ne kompaninë "....." i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Malit te Zi, i identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr., posedon numër telefoni, i pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se,

Me dt. 04.07.2019 rreth orës 11:20 ne rrugën, pikërisht ne fsh., shkel ligjin mbi trafikun publik nenin 151 par. 1 dhe rrezikon jetën e njerëzve ku i shkakton lëndime te renda trupore tjetrit dhe atë te fëmijës L. S., ne at mënyrë qe gjersa i pandehuri ishte me automjetin e tij te tipit "..... me ngjyre te zeze dhe me targa te regjistrimit, me te arritur tek ura e fshatit ne mënyrë te pa kujdesshme del ne rruge fëmija, ne pamundësi te ndaljes i njëjti e godet ne pjesën e pare te anës se djathte duke e rrezuar për toke dhe nga kjo goditje fëmija L. S. sipas ekspertizës mjeko ligjore pëson lëndime te renda trupore.

- Me çka ka kryer vepër penale, **Rrezikimi i trafikut publik**, parashikuar nga neni 378 par. 8, lidhur me par. 6, e lidhur me par.1, te KPRK-se.

Andaj, gjykata komfor neneve: 2,7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 23 par. 1 dhe 2, 39, 40 par.1 pika 1,2, 44 par.1,2, 64 par.1,2 dhe 378 par.8, e lidhur me par. 6, e lidhur me par.1, te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, 453 par. 1, 461 par. 1 te KPPRK-se, të pandehurin e:

G J Y K O N

- Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj.
- Dënim *me burg me pëlqimin* e te dënuarit, e në përputhje me nenin 44 par.1, të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumen prej **600 (gjashtëqind)** euro, e të cilin dënim i pandehur ka për ta paguar në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- Obligohet i pandehuri qe në emër të shpenzimeve të procedurës penale te paguaj shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, përderisa në emër të taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumë prej 30 euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Ndaj të dënuarit H. B. e në kuptim të nenit 64 par.1,2 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIM PLOTESUES:

-Ndalimi i drejtimit te automjetit në kohëzgjatje prej 1(një)viti, nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II Nr.883/19 të datës 13.06.2019, kundër të akuzuarit H. B. nga, për shkak të veprës penale, *rrezikim i trafikut publik*, parashikuar nga neni 378 par.8 e lidhur me par.6 të KPRK-së.

Gjykata, mbajti shqyrtimin fillestar, me datë 15.04.2021, ne praninë e Prokurores së Shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurit H. B., perf. ligjor te dëmtuarës B. S. bashke me te dëmtuarën-të miturën L. S., në të cilën seancë i pandehuri pasi që u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pasi që prokurorja e shtetit ia lexoj aktakuzën, i akuzuari u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, i premtion gjykatës se nuk do përsëris me veprime te tilla, ndihet i penduar për atë çfarë ka ndodhur.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurores dhe perf. Ligjor të dëmtuarës, të cilët nuk e kundërshtuan pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 2, të KPPRK-se, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe duke u ndërlidhur me atë se, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par 4, të KPPRK-së, atëherë, në këtë çështje penale, nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë dhe mendimit të prokurores së shtetit dhe deklaratës së për. Ligjor të dëmtuarës, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit rrjedh se në veprimet e të pandehurit H. B., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, ***Rrezikimi i trafikut publik, parashikuar nga neni 378 par 8 lidhur me par. 6 e lidhur me par.1, të KPRK-se.***

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri nuk ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pas parasysh se nga praktika në shumtën e rasteve kjo veprë penale kryehet nga pakujdesia. Gjatë procedurës penale, nuk janë paraqit rrethana të cilat kishin për ta përjashtoj tërësisht përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte para organeve të drejtësisë dhe gjatë shqyrtimit fillestar në gjykatë, duke pranuar fajësinë, dhe duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij, duke shprehur keqardhje dhe kërkim falje në seancë në drejtim të perf. Ligjor i te dëmtuarës, babai i te dëmtuarës, B. S. dhe të miturës L. S., e duke i premtu gjykatës që nuk do përsëris me veprime të tilla. Përkushtimin dhe përkujdesi i të pandehurit duke e vizituar të miturën në Spitalin Regjional të Pejës, menjëherë pas ndodhjes së rastit dhe kontaktet intersuse të tij me përfaqësuesin ligjor të miturës, e që këtë deklaram të pandehurit nuk e pohon asë perf. Ligjor i te dëmtuarës, babai i te dëmtuarës, B. S. i cili u deklaroi në seancë, që i pandehuri H. B. është përkujdesur tërësisht për vajzën në spital dhe që së bashku në jemi pajtuar duke shtu se sa i përket neve si palë nuk parashtrijm kurrfarë kërkese për dëmshpërblim dhe as kishim për të kërkuar ndjekje penale ndaj të njëjtit (të pandehurit), shton se këtë e thotë në

emër tij si përfaqësues ligjor, i vajzës së të miturës ku edhe më këtë të fundit jemi akorduar për nj deklaram. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit nga burgimi prej 6(gjashtë) muajve, në dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqindë) euro, gjykata e mori pasi që u shpallë aktgjykimi burimor, kurë i pandehuri ishte i pranishëm në shpallje dhe përmes procesverbalit shtesë të përpiluar menjëherë pas shpallje shprehu vullnetin për nj zëvendësim të tillë të cilën gjykata e vlerësoj si të arsyeshëm dhe në përputhje me nenin 44 par.1,2 e miratoi nj propozim mbi zëvendësimin tani të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga dënimi me burgim në dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, ngase gjykata vlerësoi se i pandehuri ka kushte për ta përmbarru bazu në të hyrat që i ka dhe i realizon nga biznesi i tij.

Vendimin mbi dënimin plotësisht të ndalimi të drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 1(nj)viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, gjykata e mori sipas propozimit të kërkuar nga Prokuroria e shtetit, në aktin akuzusë e në përputhje me nenin 64 par.1,2 të KPRK-ës.

Vendimin për detyrimin e të dënuarit që në emër të shpenzimeve të kujuar gjatë zhvillimit të procedurës penale në shumë prej 50 euro për tu pagua, gjykata, e mori në përputhje me nenin 453 par.1 të KPPRK-së, përderisa

Vendimin emër të kompensimit të viktimave, duke e obligo të akuzuarit që ta paguaj shumën prej 30 €, e mori në përputhje më nenin 39 par. 1, 2, 3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave.

Konfirmo nenit 461 par.1, Gjukata vendimin për kërkesën pasurore juridike e mori pasi që për. i të dëmtuarës Besnik Sofja hoqi dorë nga propozimi për kërkesën pasurore juridike që ta realizojë në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi komfor nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
-Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.51/20 me dt. 16.04.2021

Zyrtare ligjore,
Ylberja Gollgani

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.